

Njoftim për Medie

Prishtinë, 9 Janar 2013

Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj me bashkëpunëtor vizitoi sot selinë e BSPK-së dhe zhvilloi një takim me drejtuesit e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

Kryetari Arifi e përgëzoi z. Haradinaj për lirimin e tij nga Tribunali i Hagës duke theksuar se kjo nuk është vetëm fitore e tij personale por fitore e gjithë Kosovës dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që tregon edhe njëherë se lufta e saj ka qenë e drejtë.

Kjo është vizita e parë që i bëhet BSPK-se nga një lider i një subjekti politik aq të madh siq është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK. Z. Haxhi Arifi tha se partitë politike trokasin në derën e BSPK-së vetëm para zgjedhjeve politike, ndërsa për të dëgjuar hallet dhe problemet e punëtorëve të Kosovës për së afërmi ndodhi vetëm sot, gjatë këtij takimi mjaft të suksesshëm në të cilin u diskutuan shumë çështje rreth gjendjes së mjerueshme të punëtorëve kosovar.

Në mes të zyrtarëve të BSPK-së prezent ishin përfaqësues të sindikatave të KEK-ut, Doganave, Administratës, Judikaturës, Shëndetësisë, Agrokompleksit, Ndërtimtarisë, RTK-së, Telekomunikacionit dhe Lidhjeve të Kosovës, Aeroportit, Industrisë Metaleve dhe Kimisë, Ekonomisë së vogël dhe Zejtarisë, Minatorët e Trepçës dhe Rrjetit të Gruas etj.

U diskutua shumë rreth procesit të privatizimit të ndërmarrjeve publike, forma e të cilit proces është e kundërshtuar nga BSPK-ja. Kryetari Haradinaj tha se privatizimi duhet të ndodhë në të mirën e qytetarëve të vendit.

“Ne jemi parti që jemi përcaktuar për privatizim, pra për transformim të pronës por me privatizim nënkupton mbrojtje të interesave të vendit, qytetarëve të vendit dhe krijimit të vlerave ekonomike të vendit”, tha ai.

Ndërsa, kryetari i BSPK-së, Haxhi Arifi, tha se duhet punuar më shumë për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

“Ne gjithmonë kemi kërkuar edhe tani kërkojmë bashkëpunim të ndërsjellë mes veti nga pozicionet ku jemi dhe të punojmë në drejtim të forcimit të Kosovës, të zhvillimit të mirëfillt ekonomik me hapje të vendeve të punës dhe shtimit të mirëqenies sociale”, tha ai.

Me këtë rast u tha se ende ka ligje të cilat nuk zbatohen në praktikë, si dhe mos nënshkrimi i kontratës kolektive. Kjo është hera e parë që një lider i një subjekti politik në vend viziton Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

Zyra për informim e BSPK-së